



Nordox 75 WG

Lënda vepruese: Oksid bakri
PËRMBAJTJA: Oksid bakri (Cu₂O)*: 83,9 %
* Ekuivalent me 75 % bakër metalik
Lëndë ndihmëse 25%
Numri i regjistrimit: KS: 49-3153-2012/31.12.2012
Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë

FUNGICID KONTAKTI ME VEPRIM PARAMBROJTËS

PËRDORIMI:

Në hardhi: eskorioza e hardhisë (*Phomopsis viticola*) në fazën e zhvillimit 1-3 (stadi D), **vrugun e hardhisë** (*Plasmopara viticola*). Trajtimi bëhet në koncentrim 0,1-0,15% (100-150 gr në 100 l ujë).

Në pemët frutore: kromën e mollës (*Venturia inaequalis*), duke e bërë trajtimin në fazën e qetësisë vegjetative në koncentrim 0,2% (200 gr në 100 l ujë), para paraqitjes së pupës së gjelbër (fenofaza B-C) në koncentrim 0,1-0,2% (100-200 gr në 100 l ujë), dhe para paraqitjes së veshit të miut (fenofaza C 3) në koncentrim 0,1% (100 gr në 100 l ujë), **djegien bakteriale** (*Erwinia amilovora*), koncentrimi varet nga fenafaza në të cilën do bëhet trajtimi: në fenofazën A-B në koncentrim 0,2% (200 gr në 100 l ujë), në fenofazën C në koncentrim 0,15% (150 gr në 100 l ujë), në fenofazën D në koncentrim 0,1% (100 gr në 100 l ujë) deri në fillim të fazës së lulëzimit të mollës (Fenofaza E-H) në koncentrim 0,03% (30 gr në 100 l ujë) në periudha kohore prej 7 ditësh. **Deformimin e gjetheve të pjeshkës** (*Taphrina deformans*), në koncentrim 0,15% (150 gr në 100 l ujë) duke e bërë trajtimin në fazën e qetësisë vegjetative.

Në ullinj: syri i palloit (*Cycloconium oleoinum*) në koncentrim 0,15% (150 gr në 100 l ujë), duke e bërë trajtimin herët në pranverë, para paraqitjes së shirave, ndërsa para lulëzimit të ullinjëve.

Në perime: vrugun e patates dhe domates (*Phytophthora infestans*) dhe **njolloshjen e zezë të gjetheve të patates dhe domates** (*Alternaria solani*), në sasi 1 kg/ha (100 gr në 30-50 l ujë për 1000 m²). Nuk bën të përdoret në kultivarët e domates me fryt të himtë. **Vrugun e kastravecit, bostanit dhe kungullit** (*Pseudoperonospora cubensis*) deri në fillim të lulëzimit, në koncentrim 0,15% (150 gr në 100 l ujë).

Kufizimet: Barin nga të mbjellat nuk duhet ta përdorni për ushqimin. Trajtimi në fazën e lulëzimit mund të ndikoj në pllenim. Mos i lëshoni në të mbjella kafshët shtëpiake. Përdorimi me anë të aviacionit nuk është i lejuar!

Mbrojtja e ujërave: Nuk bënë të përdoret në zonat e mbrojtura ujore, vende për ngrumbullim të ujit, afër puseve, lumënjve, liqeneve, kanaleve të ujit etj. Dhe duhet që trajtimi të bëhet më së paku 20 m larg tyre. Materialet e mbetura nuk duhet të hidhen në kanalizim.

Përgatitja e tretësirës për përdorim: sasia e nevojshme përzihet me pak ujë dhe tretet gjersa nuk mbesin boca të patretura apo deri sat ë krijohet masë në formë paste, kështu që pastaj në të njejtën enë i shtihet sasia e ujit duke e bërë përyerjen e përhershme dhe qitet në rezervuarin e spërkatëses deri në gjysëm të mbushur me ujë. Në fund mbushet spërkatësja me sasinë e nevojshme të ujit. Duhet siguruar përzierja e përhershme edhe gjatë trajtimit, me qëllim të evitimit të ngurtësimit të tretësirës.

Fitotoksiciteti: është i mundur nëse bëhet trajtimi gjatë motit me lagështi dhe në të ftohtë, si dhe në kohën kur nuk është i lejuar përdorimi i preparative me bazë bakrit në pemishtet.

Nuk bën të **PËRZIHET** me insecticide acidike dhe ditiofosforike (preparate që kanë pH më të ulët se 5.5) dhe plehra.

Karenca: 14 ditë për patate, bostan, dhe domate (në fushë dhe në serra), 28 ditë për kungull, 56 për ullinj. Për kastravec dhe mollë duhet siguruar me kohën e përdorimit. Nëse nuk respektohet koha e përdorimit karenca në hardhi në mënyrë depresive vepron kalbëzimi.

Ndalesa për punë: 24 orë.

PERIUDHA E RUAJTJES: 3 vjet. Preparati ruhet në ambalazhin original, në vende të ajrosura, pa lagështi dhe jo në kontakt me rrezet e diellit. Evitoni ruajtjen në temperatura mbi 35° C.

VEPRIMI ME AMBALAZHIN DHE MBETJET E TRETËSIRËS: Ambalazhi menjëherë duhet pastruar pas harxhimit, ndërsa tretësira qitet në pompë dhe shpërndahet. Ambalazhin e pastruar dhe mbetjet e tjera të ambalazheve të pesticideve duhet ruajtur deri në momentin e dorëzimit të ngrumbulluesit të autorizuar për mbetjet e rrezikshme.

MASAT PARAMBROJTËSE: Është i dëmshëm nëse gëlltitet. Ngacmues për sytë. Përdorimi i preparatit sipas rekomandimebe të prodhuesit dhe koncentrimit të përcaktuar nuk paraqet rrezik për shëndetin e përdoruesit, duke ju përmbajtur kushteve të mjaftueshme për masat e sigurisë gjatë punës dhe respektimit të udhëzimeve të përdorimit. Gjatë punës duhet të vishni pajisjet mbrojtëse përkatëse, dorezat dhe pajisjet mbrojtëse për sy/fytyrë. Gjatë punës nuk duhet të hani, pini dhe thithni duhan. Mos spërkatni në drejtimin e kundërt të lëvizjes së erës. Evitoni depërtimin e preparatit në organizëm duke bërë mbrojtjen me pajisjet spërkatëse. Për mbrojtjen e organeve të frymarrjes përdorni maskën mbrojtëse kundër helmeve me filter për ndelimin e futjes së plhurave me filter që ka shenjen P. Duart duhet të mbrohen me doreza gome, ndërsa trupi me pajisje prej materiali të butë dhe me mëngë të gjata. Nëse raste për mbrojtjen e trupit prej kimikateve duhet përdorur përparësen prej gome. Për mbrojtjen e syve duhet përdorur syzat mbrojtëse apo helmetën që puthiten mire për lëkurë, të domosdoshme për përdorim janë edhe gjatë përgatitjes së tretësirës. Pas mbarimit të punës duhen pastruar duart dhe pajisjet mbrojtëse me ujë dhe sapun.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN: Nëse është shkaktuar thithaj, personin e aksidentuar duhet larguar nga vendi i kontaminimit dhe e vendosim në një vend të pastër apo të ajrosur ose në ajër të pastër dhe menjëherë lajmërohet mjeku. Në rast se i helmuari nuk merr frymë, menjëherë duhet të fillohet me frymëmarrje artificiale. Në rastet e kontaktit me lëkurën, duhet hequr pajisjet e kontaminuara dhe pastrohen me ujë së bashku me pjesët e prekura të trupit. Me ujë të ngrohtë të rrjedhshëm dhe me sapun më së paku deri 15 minuta dhe në rast se simptomat ende janë të pranishme, larja duhet të vazhdojë dhe të kërkohet ndihma e mjekut. Në rastet e kontaktit me sytë, ato duhet të lahen me ujë të ngrohtë dhe me sapun më së paku 15 minuta. Nëse dhimbjet, djegjet dhe simptomat e tjera janë të pranishme edhe gjatë asaj kohe nuk duhet ndalur shpëlarjen me ujë dhe sa më parë duhet kërkuar ndihmën e mjekut. Nëse ka ardhur deri te gëlltitja e tretësirës, mos e nxitni vjelljen. Personit që është para alivancës duhet ti bëhet pastrimi i gojës me ujë dhe në ndërkohë përgatitet karboni aktiv (30 gr duhet të përzihen në gjeten e ujit me ujë dhe pihet) dhe shpejtë duhet dërguar në ndonjë shtëpi shëndeti të afërt. Nuk ka antidot specifik. Është i nevojshëm mjekimi simptomatik.

Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.

MASAT NË RASTE TË AKSIDENTIT: personi i cili gjendet në hapësirën e kontaminuar, duhet të veshë pajisjet mbrojtëse (çizme të gomës, rroba të gomës, doreza mbrojtëse) dhe duhet të mbajë maskën, apo gjysmë maskën me filter vështirë të depërtueshme që ka shenjen me shkronjën P. Materiali i derdhur ngrumbullohet me material që thith atë (dhe i terur apo rërë), dhe pastaj e tëra ngrumbullohet dhe qitet në kontejner i dedikuar për këtë qëllim, Pastaj vendi i kontaminuar pastrohet me ujë dhe detergjent apo 5% të hidroksidit të natriumit dhe të gjitha këto përsëri grumbullohen dhe qiten në kontejner. Në rastet kur personi është i pambrojtur është prekur nga tretësira, menjëherë duhet vepruar sipas udhëzimeve për dhënjën e ndihmës së parë. Në rastet e paraqitjes së zjarrit, duhet ndaluar atë me CO₂ me kusht që të përdoren pajisjet për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes (me pajisje të përhershme për frymëmarrje me qark të hapur ose të mbyllur).



HELMUES PËR PESHQIT DHE PËR ORGANIZMAT E TJERA UJORE.
Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: NORDOX AS,
Ostensjovein 13, N-0661 Oslo, Norway

DISTRIBUTORI: SYNGENTA Crop Protection AG,
Basel, Switzerland
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax: +41 61 323 12 12